



Dokument Veprimi për dhunën dhe sigurinë në shkollat publike të Komunës së Prishtinës

Dokument bazë për hartimin e
platformës së Komunës së Prishtinës,
për siguri në shkolla 2015-2018



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE
NGA POPULLI AMERIKAN



*Empowered lives.
Resilient nations.*



*Empowered lives.
Resilient nations.*

Shkruar nga:
Labinot Salihu – Analist

Menaxhimi organizativ dhe operativ:
Atdhe Hetemi – Menaxher i Projektit Pulsi Publik

Mbështetje me analiza statistikore
Qendra ENCOMPASS

Sigurimi i Cilësisë:
UNDP - Ekipi për politika, hulumtim, çështje gjinore dhe komunikim
Arbërie Nagavci - Drejtoreshë e Arsimit, Drejtorja Komunale e Arsimit - Komuna e Prishtinës

Përmbledhje ekzekutive

Dhuna në shkolla është një nga fenomenet më shqetësuese të shoqërisë sonë (Ministria e Punëve të Brendshme & Ministria e Arsimit, 2009). Përkundër strategjive të aprovuara kundër kësaj dukurie, trendet e dhunës në shkolla mbeten shqetësuese. Ky studim është realizuar me kërkesë të Drejtorisë Komunale për Arsim në Komunën e Prishtinës, dhe të dhënat e dala do të shërbejnë për hartimin e platformës gjithëpërfshirëse 2015-2018 kundër dhunës në shkollat e Komunës së Prishtinës. Ky raport përmbledh të dhënat e 353 nxënësve, 82 prindërve dhe 84 mësimitdhënësve. Rezultatet e këtij hulumtimi tregojnë se gjendja në shkollat publike të Komunës së Prishtinës sa i përket sigurisë në përgjithësi, nuk është e mirë. Janë 21% të nxënësve që ndihen jo aq të sigurt në shkollë, dhe 47% e prindërve që ndajnë të njëjtin opinion kur fëmijët e tyre janë në shkollë. Përgjithësisht, kafeteritë jashtë shkollës, oborri i shkollës dhe tualetet identifikohen si vende më pak të sigurta nga nxënësit dhe prindërit e nxënësve. Ndërkaq, koha më pak e sigurt sipas nxënësve është ajo gjatë kthimit në shtëpi dhe gjatë pushimit në mes të orëve. Rrugës për në shkollë, janë mjetet e komunikacionit ato që e cenojnë sigurinë e nxënësve, qentë endacakë dhe ngacmimet që nxënësit marrin nga bandat dhe huliganët. Duke marrë parasysh pasigurinë që i shoqëron nxënësit gjatë kohës që shkojnë në shkollë dhe qëndrojnë në shkollë, nxënësit kërkojnë prezencë të policisë përmes policëve civil dhe përmes vizitave apo patrullimeve të rregullta.

Adresa më e sigurt për shumicën e nxënësve, prindërve dhe mësimitdhënësve për të raportuar kërcënimet që mund të kenë në shkollë janë kujdestari i klasës dhe drejtori i shkollës.

Këta të fundit, për të sfiduar dhunën në shkolla kanë hartuar kode të mirësjelljes, mirëpo këto nuk janë shumë të njohura për nxënësit dhe prindërit e tyre. Po kështu, edhe sjelljet e nxënësve që bien ndesh me rregulloren e shkollës janë të larta. Pothuajse çdo i treti mësimitdhënës, nxënës dhe prind deklaroi që gjatë gjysmëvjetorit të kaluar ka ndodhur të paktën një herë, që një nxënës të ketë ofenduar një mësimitdhënës, apo ky i fundit të ketë ofenduar rëndë një nxënës.

Gjithashtu, janë 45% të nxënësve që deklarojnë se gjatë gjysmëvjetorit të kaluar një mësimitdhënës ka goditur apo rrahur një nxënës. Zënkat në mes të nxënësve janë problemet më së shpeshti të raportuara në shkollat e Prishtinës, por nuk mungojnë as zënkat nxënës-mësimitdhënës.

Rreth 20% e nxënësve, mësimitdhënësve dhe prindërve mendojnë që në shkolla përdoret droga dhe alkooli nga disa nxënës. Për më tepër, ata raportojnë edhe raste kur nxënësit janë përfshirë në rrahje dhe përleshje me armë zjarri.

Një numër i konsiderueshëm i nxënësve shfaqen tolerant ndaj përdorimit të ndëshkimit fizik nga mësimitdhënësit. Prindërit dhe mësimitdhënësit janë më të rezervuar në këtë drejtim dhe nuk preferojnë përdorimin e dhunës fizike nga ana e mësimitdhënësit. Sipas nxënësve dhe mësimitdhënësve, në shkollat e Prishtinës më së lehti është që të sigurohet duhani, alkooli dhe armët e ftohta.

Ndër strategjitë më të përdorura deri më tash kundër dhunës kanë qenë instalimi i kamerave të sigurisë, uniformat shkollore dhe rojet e shkollës. Ndërkaq, vet mësimitdhënësit pohojnë se masën më të shpeshtë që e përdorin për të mbajtur disiplinën në klasë është dënimi verbal dhe njoftimi i prindërve në rast se fëmija performon ndonjë sjellje që është kundër rregullave dhe kodeve të shkollës. Përfundimisht, nxënësit, mësimitdhënësit dhe prindërit pajtohen që infrastruktura shkollore në Prishtinë ka nevojë për intervenim. Gjithashtu, sipas tyre, për të sjellë në nivel të mirë funksionimin e trekëndëshit nxënës-prind-mësimitdhënës, nevojitet funksionimi i këshillave të shkollave.

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	5
Hyrje	7
Gjendja e përgjithshme e sigurisë në shkollat publike në Prishtinë	7
Qëllimi dhe metodologjia	7
Rezultatet	8
Perceptimi i sigurisë në shkollë nga nxënësit, prindërit dhe mësimdhënësit	8
Rreziku më i madh me të cilin ballafaqohen nxënësit rrugës për në shkollë	10
Adresa e raportimit të kërcënimit për nxënësit, prindërit dhe mësimdhënësit	11
Kodet e mirësjelljes në shkollat e Prishtinës	12
Toleranca ndaj ndëshkimit fizik në shkolla	12
Përhapja e sjelljeve të papërshtatshme të nxënësve në shkolla	14
Strategjitë e shkollave kundër dhunës	17
Masat ndëshkuese si masa edukative	18
Roli i mësimdhënësve në procesin edukativo-arsimor	19
Roli i prindërve në procesin edukativo-arsimor	19
Rezultatet e Fokus Grupeve	21
Infrastruktura	21
Dhuna si fenomen dhe definimi i masës disiplinore	21
Këshillat e shkollave dhe masat edukative	22
Konkluzione	23
Rekomandimet	24

Hyrje

Gjendja e përgjithshme e sigurisë në shkollat publike në Prishtinë

Në dekadën e fundit, dhuna në shkolla është rikthyer në një shqetësim serioz për shumë vende të botës (Hiatt, 2012). Raportet e ndryshme kanë treguar se edhe në shkollat tona, dukuritë e tilla si shkelja e rregullave, ngacmimi, rrahjet, prania e armëve të ftohta dhe armëve të zjarrit kanë shënuar trende shqetësuese (Ministria e Punëve të Brendshme & Ministria e Arsimit, 2009).

Institucionet e Egzekutive deri në vitin 2013 nuk kanë pasur program dhe platformë të qartë për të parandaluar aktet e dhunshme në shkolla. Iniciativat për parandalimin e dhunës nuk kanë mundur, por ato kanë qenë kaotike, të pa sinkronizuara midis institucioneve dhe implementimi i iniciativave ka qenë i paplanifikuar brenda shkollave. Si rezultat i iniciativave të tilla, janë hartuar dhjetëra strategji dhe plane veprimi, si Strategjia për siguri në shkolla (MPB & MASHT, 2009) apo Rregullorja QRKNR. 21/2013 për protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar (MASHT, 2013). Megjithatë, të pakta kanë qenë ato që kanë gjetur zbatim praktik në shkollat e Prishtinës. Kjo ka shtyrë që drejtorët e shkollave të marrin iniciativa për hartimin e rregulloreve të brendshme, për të ruajtur disiplinën dhe për të parandaluar dhunën. Përderisa, Ministria e Arsimit, Drejtoritë Komunale për Arsim dhe shkollat kanë hasur në vështirësi dhe sfida të ndryshme përgjatë përpjekjeve për të implementuar aktivitete kundër dhunës, rezultatet e hulumtimeve të kohës së fundit që janë realizuar ofrojnë të dhëna shqetësuese.

Sipas raportit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, 24% e nxënësve janë përfshirë në rrahje fizike në 12 muajt e fundit. Përpos dhunës fizike, janë 24% e adoleshentëve që kanë përjetuar dhunë psikologjike në formën e ngacmimit nga të tjerët, teksa janë 20% që pranojnë se kanë ngacmuar të tjerët (OBSh, 2014). Sidoqoftë, të dhënat e këtyre hulumtimeve janë të përgjithshme dhe nuk ofrojnë mundësinë e identifikimit të shkaqeve dhe burimeve të pasigurisë së nxënësve. Po kështu, deri më tani kanë munguar hulumtimet që tentojnë shtjellimin e fenomenit të dhunës në shkolla, duke sjellë perspektivën e trekëndëshit “nxënës-prindër-mësimdhënës”.

Qëllimi dhe metodologjia

Duke marrë parasysh gjendjen ekzistuese, ky hulumtim ka për qëllim pasqyrimin e perceptimeve që kanë nxënësit, prindërit dhe mësimdhënësit për dhunën dhe sigurinë në shkollat publike të Komunës së Prishtinës. Hulumtimi për sigurinë në shkollat publike është hartuar me kërkesë të Komunës së Prishtinës, Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA). DKA ka planifikuar 3 hapa gjatë vitit 2014, për të siguruar qasje të përhershme dhe institucionale lidhur me çështjet e sigurisë në shkollë, duke investuar në programe afatgjate për parandalimin e veprimeve të dhunshme.

Hapi i parë është identifikimi i problemeve dhe sfidave kryesore, që pretendohet të bëhet përmes këtij hulumtimi dhe këtij raporti, duke vazhduar pastaj me hartimin e platformës gjithëpërfshirëse 2015-2018. Në këtë platformë do të detajohen hapat konkretë dhe të përditshëm, të cilët do të adresojnë çështjet e sigurisë në shkolla. Hap i dytë do të jetë themelimi i zyrës komunale për siguri në shkolla, zyrë kjo e cila do të jetë kompetente për të implementuar aktivitetet e parapara në platformë. Gjatë hartimit të platformës për siguri në shkolla, ekspertët e kyçur në këtë proces, do të shfrytëzojnë të gjeturat e këtij hulumtimi, më pastaj sipas nevojës dhe drejtimit në të cilën do të orientohet platforma, do të analizohen pjesë të veçanta të të gjeturave nga ky hulumtim. Ky raport përmbledh të dhënat e 353 nxënësve, 82 prindërve dhe 84 mësimdhënësve. Të përzgjedhur në mënyrë të rastësishme, nxënës të moshave nga 11 deri në 19 vjeçare (mesatarja 14.6 vjeç) janë bërë pjesë e këtij hulumtimi. Nga 353 nxënësit e anketuar 52% janë djem dhe 48% vajza.

Nxënësit, prindërit dhe mësimdhënësit përpos që kanë plotësuar një pyetësorë të strukturuar kanë qenë edhe pjesë e fokus-grupeve të realizuara, me ç'rast është mundësuar jo vetëm identifikimi i trendeve, por edhe hulumtimi i shkaqeve dhe nxjerrja e rekomandimeve konkrete për parandalim të dhunës në shkollat e Prishtinës. Përpos analizës përshkruese statistikore, ky raport përmban edhe analiza konkluduese (inferenciale) të të dhënave.


Rezultatet

Perceptimi i sigurisë në shkollë nga nxënësit, prindërit dhe mësimdhënësit

Nxënësit, prindërit dhe mësimdhënësit kanë përshtypje dhe perceptime të ndryshme sa i përket sigurisë në shkollë. Përderisa mësimdhënësit dhe nxënësit ndihen të sigurt gjatë kohës sa qëndrojnë në institucionet shkollore, jo e njëjta ndjenjë i përcjellë prindërit për fëmijët e tyre.

Pothuajse gjysma e prindërve (47%), ndihen jo aq të sigurt për fëmijët e tyre gjatë kohës kur ata janë në shkollë. Në anën tjetër, vetëm 21% e nxënësve ndihen jo aq të sigurt në shkollë, kundrejt 78% që deklarojnë se ndihen të sigurt apo shumë të sigurt. Po kështu, pjesa më e madhe e mësimdhënësve (88%) deklarojnë se ndihen të sigurt apo shumë të sigurt në shkollë. Vetëm rreth 1% e nxënësve, prindërve dhe mësimdhënësve ndihen shumë të pasigurt në institucionet shkollore.

Figura 1. Niveli i ndjenjës së sigurisë në shkollë, sipas nxënësve, prindërve dhe mësimdhënësve




Rezultatet tregojnë që nxënësit nga qytetet (që jetojnë në qendër dhe ata që jetojnë në periferi) ndihen më të pasigurt në shkollë, krahasuar me nxënësit që vijnë nga fshatrat. Gjithashtu, rezultatet tregojnë që sa më të rritur të jenë nxënësit aq më të pasigurt ndihen ata në shkollë. Krahasimi i nxënësve të shkollave të mesme të ulëta dhe shkollave të mesme të larta, tregon që këta të fundit raportojnë nivel më të lartë të pasigurisë.

Në anën tjetër, dallimet mes mësimdhënësve dhe nxënësve janë të mëdha kur iu kërkohet që të identifikojnë hapësirat e shkollës ku nxënësit ndihen të pasigurt. Janë 57% e mësimdhënësve dhe 24% e nxënësve, që e konsiderojnë se kafiteritë jashtë shkollës janë ambienti ku siguria e nxënësve mund të cenohet. Në anën tjetër, ¼ e nxënësve dhe mësimdhënësve e konsiderojnë oborrin e shkollës si hapësirë e dytë më të pasigurt për nxënësit.

Tualetet gjithashtu identifikohen si hapësira të pasigurta nga 1/5 e nxënësve dhe 1/10 e mësimdhënësve, përderisa hapësirat e tjera si shkallët, laboratorët, parkingu dhe bufeja e shkollës renditen në fund të listës së ambienteve të pasigurta në shkollë.


¹ Me qëllim që raporti të jetë sa më i qartë për lexuesit, të gjitha rezultatet e analizave konkluduese statistikore (T-test, ANOVA, korelacioni dhe analiza regresionale) janë interpretuar dhe dokumenti nuk përmban formulat e testeve statistikore. Kur janë krahasuar dy grupe (p.sh. djem dhe vajza), është përdorur analiza statistikore T-test. Kur është parë ndërveprimi i dy variablove është përdorur analiza korelacionale. Kur janë analizuar dallimet mes tri apo më shumë grupeve, është përdorur ANOVA. Kur është analizuar ndikimi i një variabli në variablen tjetër, është përdorur analiza regresionale. Në raport janë përfshirë vetëm rezultatet signifikante (p < .05).

Figura 2. Ambientet më të pasigurta në shkollë, sipas nxënësve dhe mësimdhënësve



Në anën tjetër, figura 2.1 tregon që meshkujt e konsiderojnë tualetin si ambientin më të pasigurt, krahasuar me vajzat, që i cilësojnë kafiteritë jashtë shkollës, si ambientet më të pasigurta.

Figura 2.1. Ambientet më të pasigurta në shkollë, sipas meshkujve dhe femrave



Pjesa më e madhe e mësimdhënësve (63%), konsiderojnë se koha gjatë shkuarjes në shkollë apo kthimit të fëmijëve në shtëpi është koha më e pasigurt për ta. Edhe pjesa më e madhe e nxënësve (44%) ndajnë të njëjtin perceptim dhe e rendisin kohën e kthimit në shtëpi si kohën gjatë së cilës ndihen më së paku të sigurt. Për ¼ e nxënësve, edhe ngjarjet shkollore si ekskursionet apo programet e shkollës identifikohen si të pasigurta.

Figura 3. Koha gjatë së cilës nxënësit dhe mësimdhënësit ndihen më pak të sigurtë





Figura 4. Rreziku më i madh me të cilin ballafaqohen nxënësit gjatë rrugës për në shkollë ose kthimit nga shkolla në shtëpi, sipas nxënësve dhe prindërve




Rreziku më i madh me të cilin ballafaqohen nxënësit rrugës për në shkollë

Pra, janë të dyja burimet, edhe nxënësit, por edhe mësimdhënësit që e konsiderojnë rrugën deri në shkollë dhe kthimin në shtëpi si periudhën më të pasigurt ditore. Përderisa dallimet në perceptimin, që kanë për sigurinë në shkollë mes prindërve dhe nxënësve janë të dukshme, jo e njëjta mund të thuhet për kërcënimet që të dyja palët i identifikojnë gjatë rrugës që fëmijët bëjnë për të shkuar në shkollë. Mjetet e trafikut janë identifikuar si kërcënim apo rreziku më i madh me të cilin ballafaqohen nxënësit gjatë rrugës për në shkollë dhe anasjelltas (grafikoni).

Qentë endacak, identifikohen si kërcënim i dytë nga 1/3 e nxënësve dhe prindërve, përderisa një përqindje e vogël (nën 10%) potencojnë ngacmimin nga njerëzit, bandat dhe huliganët si rrezikun e tretë të mundshëm.

Figura 4.1. Rreziku më i madh me të cilin ballafaqohen nxënësit gjatë rrugës për në shkollë ose kthimit nga shkolla në shtëpi, sipas meshkujve dhe femrave




Grafikoni 4.1 tregon se nuk dallimet mes vajzave dhe djemve nuk janë të mëdha, kur kërkohet prej tyre që të identifikohet rreziku më i madh me të cilin ballafaqohen nxënësit gjatë rrugës për në shkollë dhe shtëpi. Sidoqoftë, ky grafikon tregon që vajzat i konsiderojnë si rrezikun më të madh qentë endacak dhe kafshat e egra, përderisa djemtë si rrezikun më të madh i konsiderojnë mjetet e komunikacionit. Vetëm një pjesë shumë e vogël e nxënësve (1%) e bëjnë rrugën deri në shkollë me përcjelljen e prindërve. Në anën tjetër, rreth 60% e nxënësve zgjedhin të ecin deri në shkollë dhe rreth 40% shkojnë në shkollë me mjete të transportit.

Adresa e raportimit të kërcënimit për nxënësit, prindërit dhe mësimdhënësit

Mbi 90% të mësimdhënësve dhe prindërve, në rast se do të kërcënohej nxënësi në shkollë do t'i drejtoheshin drejtorit të shkollës apo kujdestarit të klasës për të adresuar një çështje të tillë. Të njëjtën gjë do ta bënin edhe 70% të nxënësve, teksa 12% prej tyre do të diskutonin një gjë të tillë me prindërit dhe 4% me shoqërinë.

Figura 5. Organit të cilit nxënësit, mësimdhënësit apo prindërit ju drejtohen më së shumti, në rast të rrezikimit ose kërcënimeve në ambientet e shkollës




Vajzat më shumë se sa djemtë do të zgjedhnin që të raportonin kërcënimin tek kujdestari i klasës, përderisa djemtë më shumë se sa vajzat do të zgjedhnin që për kërcënimet t'i drejtoheshin shoqërisë për ndihmë. Të tilla dallime shfaqen edhe kur krahasohen nxënësit e shkollave të mesme të ulëta (SHMU) me ata nga shkollat e mesme të larta (SHML).

Këta të fundit parapëlqejnë që për kërcënimet të raportojnë tek familja apo edhe shoqëria, për dallim nga nxënësit e SHMU, që preferojnë që problemin ta adresojnë tek kujdestari apo drejtori i shkollës.

Preferencat e nxënësve, prindërve dhe mësimdhënësve për prezencën e Policisë në Shkollë

Figura 6. Preferencat e nxënësve, prindërve dhe mësimdhënësve për formën e prezencës së policisë në shkollë




Të tri palët e përfshira në këtë hulumtim, do të preferonin një prezencë të policisë civile në shkollë, teksa opsioni i dytë më i pëlqyer është involvimi i policisë në shkollë nëpërmjet ligjëratave edukative. Po kështu, një pjesë e vogël e mësimdhënësve (8%), prindërve (12%) dhe nxënësve (22%) kërkojnë prezencën e policisë përmes vizitave apo patrullimeve.

Kodet e mirësjelljes në shkollat e Prishtinës

Jo rrallë, kodet e mirësjelljes janë përmendur si alternativa efikase për parandalimin e dhunës dhe promovimin e sigurisë në shkolla. Kodet e mirësjelljes i përcaktojnë qartë rregullat e sjelljes së nxënësve në shkollë dhe sanksionet në rast të devijimit apo mosrespektimit të tyre. Megjithatë, ¼ e nxënësve dhe prindërve nuk e dinë nëse shkolla ka një kod të mirësjelljes. Por, siç mund të shihet edhe në figurën e mëposhtme, 97% të mësimdhënësve raportojnë se shkollat ku ata punojnë kanë kodin e tyre të mirësjelljes.

Figura 7. Përqindja e nxënësve, prindërve dhe mësimdhënësve të cilët janë në dijeni mbi ekzistencën e kodit të mirësjelljes në shkollë




Shumica e shkollave për të adresuar problemet e sigurisë së tyre kanë themeluar Këshillin e Sigurisë. Sipas raportimit të mësimdhënësve, këshillat e sigurisë përbëhen nga prindërit (40%), arsimtarët (37%), drejtori (37%) dhe nxënësit (27%). Sipas raportimit të mësimdhënësve, këshillat e sigurisë janë funksional vetëm në 49% të shkollave. Në anën tjetër, janë 35% të mësimdhënësve që deklarohen se shkolla nuk ka këshill të sigurisë ose nuk janë të informuar për ekzistencën e këtij këshilli. Në ato shkolla ku këshilli i sigurisë është funksional, takimet e këtij organi raportohen të jenë të shpeshta. Janë 26% të mësimdhënësve që deklaruarohen që këshilli është mbledhur dy herë gjatë gjysmëvjetorit të parë, 10% kanë thënë që është takuar tre herë, ndërsa 26% thonë që ky këshill është takuar më shumë se tre herë. Nga kjo kuptohet që jo në secilën shkollë ky këshill është i organizuar dhe funksionon në të njëjtën mënyrë.

Toleranca ndaj ndëshkimit fizik në shkolla

Pjesa më e madhe e nxënësve (52%) pajtohen që ndëshkimi fizik në shkollë mund të tolerohet në raste specifike. Njësoj mendojnë edhe 40.5% e prindërve. Ndërkaq, 23% e mësimdhënësve pajtohen që ndëshkimi fizik në shkolla duhet të tolerohet në raste të veçanta.

Rezultatet regojnë që nxënësit e shkollave të mesme të ulëta janë më tolerantë ndaj dhunës, krahasuar me nxënësit e shkollave të mesme të larta. Nxënësit më të vegjël në moshë janë më tolerant ndaj përdorimit të ndëshkimit fizik në raste specifike. Rezultati tregon që sa më e madhe që të jetë moshë, aq më e vogël është toleranca ndaj ndëshkimit fizik.

Figura 7. Përqindja e nxënësve, prindërve dhe mësimitdhënësve të cilët janë në dijeni mbi ekzistencën e kodit të mirësjelljes në shkollë



Në tabelën e mëposhtme mund të shihet që nxënësit janë më tolerant për përdorimin e llojeve të ndryshme të ndëshkimit fizik në shkollë. Pjesa më e madhe e tyre (49%) konsiderojnë se përdorimi i dhunës varet nga situata dhe 8% deklarojnë se shuplaka është e paevitueshme. Nxënësit shfaqen tolerant edhe ndaj formave të tjera të dhunës, teksa e konsiderojnë se tërheqja e veshit (58%), tërheqja e flokëve (41%) dhe goditja në kokë apo në trup (21%) janë praktika të paevitueshme apo që varen nga situata. Më pak tolerant në këtë drejtim janë prindërit, që shfaqen të rezervuar për përdorimin e ndëshkimeve fizike.

Tabela 1. Opinione mbi llojet e ndëshkimeve fizike sipas nxënësve, prindërve dhe mësimitdhënësve

		Të paevitueshme	Rrallëherë	Ndonjëherë	Shpeshherë
Shuplaka	Mësimitdhënësit	1.3 %	9.3 %	77.4 %	12 %
	Prindërit	5 %	27.5 %	57.5 %	10 %
	Nxënësit	8.2 %	49 %	33.4 %	9.4 %
Tërheqja e veshit	Mësimitdhënësit	1.4 %	6.8 %	76.7 %	15.1 %
	Prindërit	2.5 %	31.7 %	51.9 %	13.9 %
	Nxënësit	10.7 %	47.5 %	28.1 %	13.7 %
Tërheqja e flokëve	Mësimitdhënësit	1.4 %	4.1 %	78.1 %	16.4 %
	Prindërit	3.8 %	20 %	61.2 %	15 %
	Nxënësit	12.2 %	29 %	44.2 %	14.6 %
Goditje në kokë apo trup	Mësimitdhënësit	0 %	0 %	83.6 %	16.4 %
	Prindërit	8.8 %	2.5 %	73.7 %	15 %
	Nxënësit	10.2 %	10.8 %	59.4 %	29.6 %
Tjetër	Mësimitdhënësit	1.4 %	2.8 %	75 %	20.8 %
	Prindërit	7.7 %	47.4 %	44.9 %	0 %
	Nxënësit	6.7 %	10.7 %	20.7 %	61.9 %


Rezultatet tregojnë që nxënësit e shkollave të mesme të ulëta dhe djemtë e konsiderojnë se format e caktuara të ndëshkimit fizik janë të paevitueshme. Ndërkaq, vajzat në masë të madhe shprehën kundër përdorimit të formave të ndëshkimit fizik për nxënësit.

Përhapja e sjelljeve të papërshtatshme të nxënësve në shkolla

Edhe pse dallimet janë të mëdha, varësisht nga burimi (nxënës, prind apo mësuesdhënësi), është e qartë që një numër i madh i sjelljeve që bien ndesh me rregulloren e shkollës kanë ndodhur në shkollat e Prishtinës, gjatë gjysmëvjetorit të kaluar. Pjesa më e madhe e respondentëve të këtij hulumtimi pranojnë që si pasojë e sjelljeve të tilla, ndonjë nxënës është përjashtuar nga shkolla përkohësisht. Ndërkaq, pothuajse 50% të nxënësve dhe 38% të prindërve (kundrejt asnjë mësuesdhënësi) janë në dijeni të ndonjë rasti që është përjashtuar tërësisht nga shkolla. Më shumë se gjysma deklarojnë që janë të informuar për të paktën një rast kur një klasë e tërë nxënësish kanë ikur nga një orë mësimore apo nga gjithë orët mësimore të një dite të caktuar.

Sipas nxënësve dhe prindërve janë më të rralla rastet kur një prind ka fyer ose ofenduar rëndë një mësuesdhënësi, por janë vet mësuesdhënësit, që një sjellje të tillë e raportojnë në nivele më të larta. Janë 17% e mësuesdhënëseve që pranojnë të ketë ndodhur një gjë e tillë gjysmëvjetorin e kaluar. Megjithatë, shumë më i lartë është numri i nxënësve, prindërve dhe mësuesdhënëseve që dinë që gjatë gjysmëvjetorit të kaluar një nxënës ka fyer një mësuesdhënësi apo një mësuesdhënësi ka fyer një nxënës. Çdo i treti nxënës apo mësuesdhënësi pranon që gjatë gjysmëvjetorit të kaluar një nxënës ka fyer rëndë një mësuesdhënësi, teksa pothuajse çdo i dyti nxënës dhe vetëm çdo i pesti mësuesdhënësi di për ndonjë rast që mësuesdhënësi të ketë fyer rëndë një nxënës.

Figura 9. Përqindja e nxënësve, mësuesëve apo prindërve, të cilët janë në dijeni të ndodhive të mëposhtme në shkollë, gjatë gjysmë-vjetorit të kaluar



Dallime të tilla mes nxënësve dhe mësimitdhënësve shfaqen edhe kur iu kërkohet që të raportojnë për rastet kur mësimitdhënësit kanë goditur apo rrahur ndonjë nxënës. Janë 45% e nxënësve dhe vetëm 2% e mësimitdhënësve që pranojnë se gjatë gjysmëvjetorit të kaluar, në shkollën e tyre, një mësimitdhënës ka goditur ndonjë nxënës. Edhe pse në nivele shumë të ulëta, gjatë gjysmëvjetorit të kaluar kanë ndodhur edhe raste të tilla, kur nxënësi apo prindi ka goditur mësimitdhënësin.

Tabela 2. Prevalenca e akteve delikuede të nxënësve


		Asnjëherë	Rrallëherë	Ndonjëherë	Shpeshherë
Vjedhja e pasurisë personale	Mësimitdhënësit	65.1 %	21.7 %	12 %	1.2 %
	Prindërit	79 %	14.8 %	5 %	1.2 %
	Nxënësit	59.4 %	21.6 %	15.6 %	3.4 %
Vjedhja e pronës se shkollës	Mësimitdhënësit	77.2 %	13.3 %	7.3 %	1.2 %
	Prindërit	87.6 %	9.9 %	2.5 %	0 %
	Nxënësit	82.2 %	12.8 %	4.7 %	0.3 %
Vandalizëm	Mësimitdhënësit	41.5 %	26.8 %	25.6 %	6.1 %
	Prindërit	51.3 %	26.2 %	17.5 %	5 %
	Nxënësit	37.5 %	28.2 %	24.3 %	10 %
Përlëshjet pa armë	Mësimitdhënësit	39.8 %	32.5 %	24.1 %	3.6 %
	Prindërit	35.8 %	25.9 %	23.5 %	14.8 %
	Nxënësit	20.1 %	25.1 %	30.3 %	24.5 %
Përlëshjet me armë	Mësimitdhënësit	90 %	10 %	0 %	0 %
	Prindërit	87.6 %	6.2 %	6.2 %	0 %
	Nxënësit	73.3 %	17.2 %	8.1 %	1.4 %
Përdorimi i drogës	Mësimitdhënësit	82.7 %	9.9 %	7.4 %	0 %
	Prindërit	82.8 %	8.6 %	7.4 %	1.2 %
	Nxënësit	77.7 %	11 %	6.9 %	4.4 %
Përdorimi i alkoolit	Mësimitdhënësit	86.8 %	9.6 %	3.6 %	0 %
	Prindërit	84 %	9.8 %	3.7 %	2.5 %
	Nxënësit	72.2 %	15.9 %	9 %	2.9 %
Shitjet e Drogës/ Alkoolit	Mësimitdhënësit	N/A	N/A	N/A	N/A
	Prindërit	96.3 %	2.5 %	1.2 %	0 %
	Nxënësit	86.3 %	6 %	4 %	3.7 %
Ngatërresa ndërmjet nxënësve	Mësimitdhënësit	14.5 %	34.9 %	41 %	9.6 %
	Prindërit	28.4 %	22.2 %	23.5 %	25.9 %
	Nxënësit	10.6 %	22.5 %	29.7 %	37.2 %
Ngatërresa me mësuesit	Mësimitdhënësit	N/A	N/A	N/A	N/A
	Prindërit	58 %	28.4 %	9.9 %	3.7 %
	Nxënësit	41.5 %	30.7 %	19.9 %	7.9 %
Ngacmimet gjatë hyrje/daljes në shkollë	Mësimitdhënësit	N/A	N/A	N/A	N/A
	Prindërit	N/A	N/A	N/A	N/A
	Nxënësit	41.4 %	32.9 %	19.9 %	5.8 %
Vizitorët e pakontrolluar në objektin e shkollës	Mësimitdhënësit	N/A	N/A	N/A	N/A
	Prindërit	N/A	N/A	N/A	N/A
	Nxënësit	46.5 %	24 %	18.7 %	10.8 %
Ngacmimet gjatë pritjes së autobusit	Mësimitdhënësit	N/A	N/A	N/A	N/A
	Prindërit	N/A	N/A	N/A	N/A
	Nxënësit	62.9 %	22.6 %	11.9 %	2.6 %

Numri i nxënësve nga shkollat e mesme të larta që pranojnë se gjatë gjysmëvjetorit të kaluar ndonjë nxënës ka mbajtur armë zjarri në shkollë, ka fyer rëndë mësimdhënësin apo është përjashtuar përkohësisht, është më i madh se sa numri i nxënësve nga shkollat e mesme të ulëta që raportojnë të njëjtat fenomene.

Po ashtu, dallimet janë të rëndësishme në këtë nivel edhe kur krahasohen nxënësit e shkollave nga fshatrat dhe qytetet, me këta të fundit, që raportojnë mbizotrim më të lartë të sjelljeve jokonformiste të nxënësve në shkollë. Përleshjet pa armë, vandalizmi, ngatërresat ndërmjet nxënësve, ngacmimet gjatë hyrje-daljes në shkollë dhe ngacmimet gjatë pritjes së autobusit, raportohen të jenë dukuritë më të shpeshta që kanë ndodhur gjatë gjysmëvjetorit të kaluar. Siç mund të shihet edhe nga tabela që pasqyron përhapjen e dukurive të tilla, rreth 20% të nxënësve, prindërve dhe mësimdhënësve të përfshirë në këtë hulumtim, raportojnë se nxënësit kanë përdorur alkool apo drogë gjatë gjysmëvjetorit të kaluar.

Për dallim nga nxënësit e shkollave të mesme të ulëta, janë nxënësit e shkollave të mesme të larta që në masë më të madhe raportojnë që në shkollën e tyre të kenë ngjarë: vjedhje të pasurisë personale, përleshje me armë, përleshje pa armë, përdorim i alkoolit apo edhe përdorim i drogave.

Figura 10. Përqindja e nxënësve dhe mësimdhënësve, të cilet e konsiderojnë si të lehtë dhe shumë të lehtë të sigurojnë duhan, droga të llojeve të ndryshme ose armë, në teritorin e shkollës.



Edhe nxënësit, por edhe mësimdhënësit pajtohen që më së lehti është që në shkollë të sigurohet duhani, armët e ftohta apo ato të zjarrit dhe alkooli. Ndërkaq, rreth 60% e nxënësve dhe mësimdhënësve thonë se është e pamundshme të sigurohet marihuanë në shkollën e tyre, pothuajse çdo i pesti thotë se kjo është mjaft e lehtë apo shumë e lehtë. Ndërkaq, drogat e tjera si amfetamina apo ekstazia sipas mësimdhënësve është shumë e vështirë apo pothuajse e pamundur që të gjinden në shkolla.

Rreth ¾ e nxënësve, mësimdhënësve dhe prindërve mendojnë se fare pak apo disa nga nxënësit e shkollës së tyre e pinë duhanin. Kjo duket të jetë edhe dukuria më e shpeshtë në shkollat e Prishtinës, gjithmonë sipas raportimit të nxënësve, prindërve dhe mësimdhënësve. Rreth 1/3 e tyre mendojnë se nxënësit përdorin alkoolin apo marijuanën (hashashin). Po ashtu, më e vogël është përqindja e atyre (rreth 10%), që mendojnë se nxënësit përdorin ekstazi apo droga të tjera. Siç mund të shihet edhe nga tabela, janë 47% e nxënësve që mendojnë se nxënësit e tjerë mbajnë me vete armë të ftohta dhe 23% e tyre që mendojnë se nxënësit e tjerë mbajnë armë zjarri.


Tabela 3. Përqindja e përdorimit të duhanit, alkoolit, drogave dhe armëve nga nxënësit e shkollës, sipas mesimdhënësve, prindërve dhe nxënësve

		Asnjë	Fare pak	Disa	Shumica
Përdorin duhanin	Mësimdhënësit	22.5 %	26.3 %	43.7 %	7.5 %
	Prindërit	23.7 %	17.5 %	42.5 %	16.3 %
	Nxënësit	29.3 %	10.6 %	33.2 %	26.9 %
Përdorin alkoolin	Mësimdhënësit	70 %	22.5 %	7.5 %	0 %
	Prindërit	68.8 %	20.5 %	7.4 %	3.8 %
	Nxënësit	55.4 %	24.4 %	17 %	3.2 %
Përdorin marijuanën ose hashashin	Mësimdhënësit	81.4 %	12.3 %	6.3 %	0 %
	Prindërit	86.2 %	7.5 %	5 %	1.3 %
	Nxënësit	72.3 %	15.6 %	9.5 %	2.6 %
Përdorin qetësues (pa recetë mjeku)	Mësimdhënësit	77.2 %	11.5 %	1.3 %	0 %
	Prindërit	83.7 %	12.5 %	3.8 %	0 %
	Nxënësit	68.8 %	18.3 %	9.5 %	3.4 %
Përdorin ekstazi	Mësimdhënësit	91 %	6.4 %	2.6 %	0 %
	Prindërit	96.2 %	3.8 %	0 %	0 %
	Nxënësit	89.3 %	8.1 %	2.3 %	3 %
Përdorin droga të tjera	Mësimdhënësit	90 %	7.5 %	2.5 %	0 %
	Prindërit	87.4 %	8.8 %	3.8 %	0 %
	Nxënësit	82.5 %	10 %	4.9 %	2.6 %
Mbajnë me vete armë zjarri	Mësimdhënësit	91.2 %	5 %	3.8 %	0 %
	Prindërit	91.2 %	6.3 %	2.5 %	0 %
	Nxënësit	77.3 %	12.4 %	6.6 %	3.7 %
Mbajnë me vete armë të ftohta	Mësimdhënësit	68.3 %	22.8 %	8.9 %	0 %
	Prindërit	61.2 %	26.3 %	12.5 %	0 %
	Nxënësit	53 %	20.9 %	17.5 %	8.6 %

Strategjitë e shkollave kundër dhunës

Sipas raportimit të mësimdhënësve (56%), kamerat e sigurisë janë masa e parë mbrojtëse kundër dhunës dhe akteve të tjera delikuede që është përdorur deri më tash. Edhe përdorimi i uniformave shkollore (48%) është metodë tjetër e sigurisë, e përcjellë nga rojet (39%) e shkollave. Ndërkaq, 24% e mësimdhënësve thonë se shkolla e tyre ka sistem të mbrojtjes nga zjarri. Përndryshe, tavolinat lajmëruese, sistemi i hyrjes me kartelë dhe bexhat e vizitorëve janë praktika që aplikohen shumë më pak, teksa nën 10% e mësimdhënësve i raportojnë ato si praktika të shkollës së tyre.

Figura 11. Metodatat e sigurisë që përdoren prej shkollave për parandalimin e dhunës




Shumica e shkollave për të adresuar problemet e sigurisë së tyre kanë themeluar Këshillin e Sigurisë. Sipas raportimit të mësimitdhënësve, këshillat e sigurisë përbëhen nga prindërit (40%), arsimtarët (37%), drejtori (37%) dhe nxënësit (27%). Sipas raportimit të mësimitdhënësve, këshillat e sigurisë janë funksional vetëm në 49% të shkollave. Në anën tjetër, janë 35% të mësimitdhënësve që deklarohen se shkolla nuk ka këshill të sigurisë ose nuk janë të informuar për ekzistencën e këtij këshilli. Në ato shkolla ku këshilli i sigurisë është funksional, takimet e këtij organi raportohen të jenë të shpeshta. Janë 26% të mësimitdhënësve që deklaruarohen që këshilli është mbledhur dy herë gjatë gjysmëvjetorit të parë, 10% kanë thënë që është takuar tre herë, ndërsa 26% thonë që ky këshill është takuar më shumë se tre herë. Nga kjo kuptohet që jo në secilën shkollë ky këshill është i organizuar dhe funksionon në të njëjtën mënyrë.

Masat ndëshkuese si masa edukative


Për mësimitdhënësit dënimi verbal (37%) është metoda më e preferuar si masë ndëshkuese për nxënësin që nuk mban disiplinën në klasë. Alternativat tjera të përdorura nga mësimitdhënësit janë edhe njoftimi i prindërve (23%) dhe njoftimi i drejtorisë (17%), teksa vetëm 12% kanë preferuar shpërblimin si mekanizëm për mbajtjen e disiplinës. Thyerja e notës së sjelljes, vlerësimi i dobët dhe përjashtimi nga ora e mësimit, janë tri instrumentet e tjera që përdoren më së paku nga ana e mësimitdhënësve.

Figura 12. Metoda e përdorur më shpesh prej mësimitdhënësve për të mbajtur disiplinën në klasë



Prindërit konsiderojnë që metoda më e përshtatshme për të mbajtur disiplinën në klasë do të ishte informimi i prindërve (63%) për sjelljen e padisiplinuar të nxënësve. Mënyra tjetër e preferuar do të ishte që nxënësit e padisiplinuar të thirren për t'u pyetur, në rast se tregohen të padisiplinuar 15%. Të tjerat metoda preferohen nga më pak se 10% e prindërve.

Figura 13. Preferencat e prindërve për metodat që duhet të përdorin mësimit për të mbajtur disiplinën në klasë



Roli i mësimit në procesin edukativo-arsimor

Roli i mësimit është qendror për të gjitha aktivitetet në klasë dhe në shkollë, që kanë për qëllim edukimin dhe parandalimin e akteve të dhunshme. Edhe ky hulumtim konfirmon një gjë të tillë dhe në veçanti vë në pah rëndësinë e mësimit kujdestar për parandalimin e dhunës në shkollë. Mbi 76% e mësimit të përfshirë në hulumtim deklarohen të jenë kujdestar të një klase në shkollën e tyre. Këta të fundit janë shumë aktiv në mbledhjet me prindër, teksa kanë deklaruar të kenë ftuar prindërit për takime 2 apo më shumë herë gjatë gjysmë vjetorit të parë. Sa i përket kënaqësisë së pjesëmarrjes së prindërve në këto takime, mësimit duken të kenë mendim të ndarë. Mbi 50% e tyre janë shumë apo mjaft të kënaqur, ndërsa pjesa tjetër janë pak apo aspak të kënaqur me pjesëmarrjen e prindërve në këto takime. Kur mësimit pyeten se sa janë prindërit të interesuar për fëmijët e tyre, 50% thonë që janë shumë apo mjaft të interesuar, ndërsa pjesa tjetër ankohet që prindërit janë pak apo aspak të interesuar për fëmijët e tyre (nxënës në klasën në të cilën mësimit është kujdestar). Mësimit kujdestarë përveç takimeve të përbashkëta me prindër, kontaktojnë edhe individualisht prindërit, por vetëm në raste të caktuara. Më së shpeshti, kujdestarët e zgjedhin këtë rrugë komunikimi me prindërit në rast të ndonjë incidenti (mbi 43%) apo në rastet kur prindi mungon në takim të prindërve. Për mësimit nuk është aspak e vështirë të mbahet rregull dhe qetësi në klasë gjatë orës së mësimin. Nga përgjigjet e dhëna nga mësimit kuptohet që gjatë orëve të mësimin në prezencë të tyre nuk ka telashe në menaxhimin e klasës. Derisa 7% e mësimit kanë deklaruar të kenë të vështirë të mbajnë qetësinë dhe rregullin në klasë apo shkollë.

Roli i prindërve në procesin edukativo-arsimor

Roli i prindit është i pazëvendësueshëm në procesin edukativo-arsimor. Përfaqësuesi i kështillit të prindërve është kryetar i Kështillit Drejtues të shkollës, organ ky kryesor për marrjen e vendimeve për shkollën dhe në përgjithësi për qeverisjen me shkollën. Kështillat e prindërve në të gjitha nivelet, nuk janë të organizuara mirë dhe se është identifikuar që nuk mbahen zgjedhje të rregullta në secilën klasë për të zgjedhur përfaqësuesin e prindërve nga klasa, duke vazhduar pastaj nga viti përkatës e kështu më tutje.

Nga ky defekt procedural, roli i prindit në qeverisje me shkollën sot vazhdon të jetë me përmasa minimale, dhe drejtori i shkollës në veçanti përdorë përfaqësuesin e prindërve vetëm për të miratuar formalisht vendime për të cilat shkolla është e obliguar ta ketë aprovimin e këshillit drejtues apo përfaqësuesit të prindërve.

Mbledhjet e prindërve nuk janë të rregullta dhe është identifikuar problem i mungesës së kujdestarëve mësimdhënës të klasave. Shumë kujdestar të klasës ankohen për pjesëmarrjen e ulët të prindërve në takimet me prindër, fëmijët e të cilëve janë nxënës të shkollës dhe kanë probleme me rregullat dhe procedurat e shkollës. Prindërit ftohen më së paku dy herë gjatë një viti shkollor në takime në shkollë për takime. Prej tyre, 51% deklarohen se janë ftuar 2 herë, 18% janë ftuar tre herë ndërsa 16% më shumë se tre herë në takimet e prindërve. Ndërkaq, 14% janë ftuar vetëm një herë ndërsa 1% asnjëherë. Një e treta e prindërve, tre apo me shumë herë kanë marrë pjesë në takime me prindër në gjysmë vjetorin e parë, 46% kanë marrë pjesë dy herë, 22% kanë marrë pjesë një herë dhe vetëm 1% nuk kanë marrë pjesë asnjëherë në takime me prindër. Prindërit preferojnë të informohen për performancën e fëmijës së tyre në mbledhjet me prindër. 70% e tyre deklarohen se këtë informatë deri më sot e kanë marrë nga takimi i klasës me prindër. Takimet individuale nuk janë shumë të preferuara as nga mësimdhënësit e as nga prindërit. Vetëm 15% e prindërve, informohen për fëmijën e tyre nga takime individuale me përfaqësuesin e shkollës.

Rezultatet e Fokus Grupeve

Përpos aspektit kuantitativ të prezantuar nëpërmjet anketimit të mësimdhënësve, nxënësve dhe prindërve, ky hulumtim ka edhe komponentën kualitative. Për të ofruar jo vetëm trendet, por për të pasqyruar në detaje arsyet dhe shkaqet e një situate të tillë, janë zhvilluar edhe tri fokus grupe me mësimdhënës, nxënës dhe prindër. Me datë 17 Shtator 2014 në objektin e Komunës së Prishtinës, janë mbajtur 3 fokus grupe, me mësimdhënës, prindër dhe nxënës të shkollave të Komunës së Prishtinës.

Në takime janë diskutuar konstatimet kryesore dhe rekomandimet e dala nga rezultatet e hulumtimit për sigurinë në shkolla në Komunën e Prishtinës. I gjithë diskutimi me fokus grupet është ndarë në 3 pjesë, ku pjesëmarrësit kanë shfaqur opinionet e tyre për infrastrukturën shkollore, dhunën si fenomen dhe rolin e funksionimit të kështillave të shkollave. Në fokus grupe të ndara kanë marrë pjesë 24 mësimdhënës, 24 prindër dhe 45 nxënës.

Infrastruktura

Mësimdhënësit, prindërit dhe nxënësit pajtohen me rezultatet e hulumtimit, që tregojnë se infrastruktura shkollore është e varfër dhe ka nevojë për përmirësime. Sipas mësimdhënësve dhe nxënësve, komunikacioni dhe qentë endacak janë rreziku më i madh që u kanoset nxënësve, por edhe mësimdhënësve të cilët në këmbë shkojnë në shkollë dhe kthehen në shtëpi. Sipas prindërve, një problem serioz janë edhe kafeteritë jashtë shkollës, që janë vërtetë ambiente të pasigurta për nxënësit. Shenjat në rrugë, pengesat fizike për shpejtësinë e vozitjes janë disa nga masat që duhet ndërmarrë sipas mësimdhënësve. Po ashtu, trotuaret e zëna nga veturat e parkuara përreth shkollës, rrisin rrezikshmërinë për aksidente dhe cenojnë sigurinë e nxënësve që detyrohen të ecin në rrugë. Është propozuar që të vendosen vijat që ndalojnë parkimin e veturave në të gjithë perimetrin përreth oborreve shkollore. Sa i përket infrastrukturës në oborr dhe brenda në shkollë, mësimdhënësit pajtohen me shumicën e konstatimeve të dala nga hulumtimi. Prindërit kërkojnë që në oborr të mos hyjë askush përveç nxënësve, prindërve, mësimdhënësve dhe personelit shkollor. Ndërkaq, nxënësit ankohen në kushtet e varfëra higjienike në shkollë. Të tri palët pajtohen që rrethojat e standardizuara nga Komuna, rojet të hyrje/daljet e oborreve shkollore dhe kamerat për vëzhgim janë mekanizma të domosdoshëm për të parandaluar veprimet e dhunshme në shkollë.

Dhuna si fenomen dhe definimi i masës disiplinore

Prindërit pajtohen që sot në shkollat e Komunës së Prishtinës nuk është e qartë se çka është një masë disiplinore dhe dhuna ndaj nxënësit. Gjatë diskutimit të këtyre çështjeve, prindërit pranojnë që mësimdhënësit dhe personeli shkollorë në raste të caktuara ndëshkon nxënësit duke përdorur dhunën. Të gjithë nxënësit pa asnjë përjashtim pohojnë që mësimdhënësit ushtrojnë dhunë, për të mbajtur disiplinën në shkollë.

Nxënësit pranojnë dhe pajtohen që mësimdhënësit por edhe drejtori i shkollës mund të ushtrojnë dhunë ndaj tyre, nëse një nxënës ka kaluar paraprakisht nëpër disa procedura disiplinore. Shumica e nxënësve të pranishëm në fokus grupe kanë thënë që edhe policia ka ushtruar dhunë ndaj nxënësve të cilët në një formë apo tjetrën kanë thyer rregullat apo disiplinën në shkollë. Një nga nxënësit pjesëmarrës në fokus grupe ka treguar që ai ka qenë dëshmitarë kur dy policë civil kanë futur dy nxënës të shkollës së tij në zyrën e drejtorit dhe nga aty nxënësit kanë dalë të gjakosur nga dhuna që është ushtruar nga policia. Por, pjesa më e madhe e mësimdhënësve e kundërshtojnë zërin se në shkollë ushtrohet dhunë. Ata megjithatë pranojnë se ngacmimet në mes të nxënësve janë prezente dhe se këto ngacmime nuk janë të natyrës serioze.

Kurse, sipas prindërve zanafilla e problemeve që kanë fëmijët me sjelljen e tyre është në familje, andaj kërkojnë intervenimin e komunës në këtë institucion shoqëror, përmes programeve shtesë të edukimit. Mësimdhënësit, që kanë marrë pjesë në fokus grupe thonë që asnjëherë gjatë kohës sa ata kanë ushtruar punën e mësimdhënësit nuk kanë përdorur dhunë për të mbajtur disiplinën në klasë apo në shkollë. Po ashtu ata deklarojnë se nuk dinë ndonjë rast kur ndonjë nga kolegët e tyre mësimdhënës ka ushtruar dhunë ndaj nxënësit. Ata e pranojnë që një pjesë e nxënësve janë mjaft të vështirë për t'u menaxhuar (nxënësit problematikë siç i quajnë ata), dhe se në këto raste kanë përdorur masa ndëshkuese, siç janë përjashtimi nga klasa, ftesa për prindërit apo masa të tjera ndëshkuese.

Për dallim prej tyre, prindërit dhe nxënësit mendojnë se për disa nxënës dhuna është e vetmja mënyrë që ata t'iu binden rregullave dhe procedurave të shkollës. Një fenomen që ndodhë dhe është mjaft shqetësues për mësimdhënës janë kërcënimet e nxënësve apo të të afërmeve të tyre ndaj mësimdhënësve. Më së shpeshti, rastet e tilla ndodhin për shkak të punës së tyre në shkollë. Mësimdhënësit kërkojnë masa të menjëhershme nga institucionet përkatëse, që kërcënimet ndaj mësimdhënësve të mos ndodhin. Në anën tjetër nxënësit kërkojnë që të marrin pjesë në takimet, në të cilat vendoset për rregullat e shkollës. Deri më tash, atyre vetëm u janë prezantuar rregullat e sjelljes nga mësimdhënësit kujdestar apo drejtorja e shkollës.

Këshillat e shkollave dhe masat edukative

Mësimdhënësit pajtohen që këshillat e shkollave duhet funksionalizuar dhe se roli i tyre duhet fuqizuar në qeverisjen me shkollën. Ata deklarojnë se këshillat e mësimdhënësve sot kanë rol dytësor dhe se nuk janë mirë të organizuar. Mësimdhënësit kërkojnë aktivizim më të madh të prindërve përmes këshillave të prindërve. Ata thonë që prindërit janë mjaft indiferent dhe se nuk angazhohen sa duhet në shkollë. Por, sipas prindërve, zgjedhjet për përfaqësues të prindërve nuk organizohen mirë dhe se ato zakonisht ndodhin kur mësimdhënësi propozon apo cakton një prind për përfaqësues të këshillit të prindit në klasën e caktuar. Ky fenomen pastaj vazhdon edhe me këshillin e prindërve në instancat tjera, por në ato raste përfaqësuesit e prindërve përzgjedhen nga drejtorja e shkollës. Kësisoj, ata pajtohen që mënyra më e mirë për të fuqizuar rolin e prindit në shkollë është përmes këshillave të prindërve, por kërkojnë më shumë korrektësi në përzgjedhje të përfaqësuesve të prindërve. Prindërit pajtohen që roli i tyre duhet të rritet në shkollë dhe kjo më së miri mund të bëhet përmes këshillave të shkollës. Këto këshilla sot janë të dobëta dhe prindi nuk ka fuqi të influencojë qeverisjen në shkollë aspak, përmes tyre.

Edhe nxënësit janë të pakënaqur me mënyrën e organizimit të këshillave shkollorë. Sipas tyre, këshillat e shkollave në masë të madhe ndikohen nga mësimdhënësi. Të gjithë nxënësit tregojnë që kujdestari ose propozon se kush duhet të jetë përfaqësues i klasës në këshillin e nxënësve ose ndikon drejtpërdrejt apo tërthorazi në zgjedhjen e përfaqësuesit. Nxënësit tregojnë po ashtu që ka pasur raste kur vet kujdestari ka zgjedhur përfaqësuesin e nxënësve për këshill, pa pyetur fare nxënësit. Këshillat e nxënësve, sipas tyre kanë rol teknik dhe nuk pyeten apo ftohen asnjëherë për të vendosur për shkollën në aspektin e mbarëvajtjes së aktiviteteve formale të shkollës apo çështjeve të sigurisë.

Konkluzione

Ky raport konfirmon të gjeturat e hulumtimeve të mëhershme që tregojnë për situatën e brishtë të sigurisë në shkollat e Prishtinës. Për më tepër, raporti ofron të dhëna të detajuara për situatën e sigurisë në shkollat Prishtinës, dhe ofron rezultate që janë të vlefshme për hartimin e platformës për siguri në shkollat e kryeqytetit. Nga rezultatet është e qartë, që çdo i pesti nxënës nuk ndihet edhe aq i sigurt në shkollë. Po kështu, prindërit janë të shqetësuar për sigurinë e fëmijëve të tyre gjatë kohës sa ata janë në shkollë. Në veçanti, kafiteritë jashtë shkollës, oborri dhe tualetet identifikohen si hapësira të pasigurta në shkollë dhe rreth saj. Janë pikërisht këto ambiente ku nxënësit ndihen të pasigurt. Gjithashtu, rruga deri në shkollë është e pasigurt për shumë nxënës dhe mësimitdhënës. Shumica ankohen për rreziqet në rrugë, si vozitjet e shpejta të veturave, qentë endacak dhe bandat, që cenojnë sigurinë e tyre.

Raporti konfirmon drejtorin e shkollës, si autoritetin kryesor, të cilit nxënësit do t'i drejtoheshin në rast se do të ndiheshin të kërcënuar. Megjithatë, edhe kujdestari i klasës është një adresë e rëndësishme për shumë nxënës, në rast se do të ndiheshin të rrezikuar apo kërcënuar. Sipas nxënësve, prindërve dhe mësimitdhënësve, edhe Policia do të ndihmonte shumë në parandalimin e dhunës dhe promovimin e sigurisë në shkolla. Që të tri palët preferojnë një prezencë civile të policisë në shkollë, që do të mundësonte më lehtë dhe pa u vërejtur identifikimin e potencialit për dhunë apo prishjen e sigurisë në shkollë. Në bazë të rezultateve të hulumtimit është e qartë, që në përpjekje për të mbajtur rendi në shkollë, shumica e shkollave kanë hartuar kodet e tyre të mirësjelljes. Megjithatë, vërehet që një pjesë e nxënësve dhe prindërve nuk janë në dijeni të kodeve të tilla dhe dinë pak për rregullat dhe sanksionet në rast të mosrespektimit. Ky hulumtim vë në pah një nivel të lartë të tolerancës së nxënësve ndaj ndëshkimit fizik.

Gjysma e tyre pajtohen që mësimitdhënësit i tolerohet që të përdor ndëshkimin fizik në raste specifike. Më pak tolerant në këtë drejtim shfaqen prindërit dhe mësimitdhënësit, që do të preferonin metoda të tjera në vend të atyre që përmbajnë dhunë. Sidoqoftë, në mesin e dënimeve të ndryshme fizike, janë shuplakat dhe tërheqja e veshit ato që tolerohen më shumë nga të tri palët. Megjithëse, dënimet e tilla raportohen në masë të madhe nga nxënësit, sërish në shkollat e Prishtinës vërehet një përhapje e lartë e sjelljeve të nxënësve që bien ndesh me rregulloret e shkollave. Rreth 1/3 e nxënësve raportojnë të paktën një rast gjatë gjysmëvjetorit të kaluar, kur një nxënës ka fyer rëndë një mësimitdhënës. Pothuajse e tillë është edhe përqindja e nxënësve që deklarojnë se mësimitdhënësit kanë fyer të paktën një herë rëndë ndonjë nxënës. Sipas raportimit të nxënësve, dhuna fizike e ushtruar nga mësimitdhënësit ndaj nxënësve është e lartë. Gjithsej, 45% e nxënësve kanë pranuar që gjatë gjysmëvjetorit të kaluar mësimitdhënësi ka goditur apo rrahur ndonjë nxënës. Dhuna e tillë fizike duket të jetë më e pranishme në shkollat e mesme të larta, krahasuar me shkollat e mesme të ulëta. Çdo i pesti nxënës, prind apo mësimitdhënës i përfshirë në këtë hulumtim, raporton se nxënësit kanë përdorur alkool apo drogë gjatë gjysmëvjetorit të kaluar. Një prevalencë e tillë e përdorimit mund të jetë edhe për faktin që sigurimi i duhanit, alkoolit, armëve dhe drogave në shkollat e Prishtinës nuk duket i pamundur.

Për të shmangur rastet e dhunës dhe për të ruajtur sigurinë, shkollat kanë planifikuar në masë të madhe kamerat e sigurisë, uniformat shkollore dhe kanë angazhuar roje. Për më tepër, mësimitdhënësit janë përpjekur që përmes dënimit verbal dhe njoftimit të prindërve për sjelljet e pahijshme të nxënësve të ulin nivelin e sjelljeve devijante dhe të parandalojnë dhunën. Megjithëkëtë, siguria në shkolla duket të jetë e cenuar dhe nivelet e dhunës mbesin shqetësuese. Këtë e konfirmojnë edhe të gjeturat e fokus grupeve. Përfundimisht, kërkohet mobilizim i të gjithë akterëve për parandalimin e akteve të dhunës dhe për promovimin e sigurisë në shkolla.

Rekomandimet

Mbështetur në të dhënat e hulumtimit, kërkesat e nxënësve, prindërve dhe mësimeve, janë dhënë rekomandimet e mëposhtme:

- Të identifikohet kufiri në mes të masës disiplinore dhe ushtrimit të dhunës si masë ndëshkuese ndaj nxënësve;
- Të inkorporohen edhe detyrat dhe përgjegjësitë e mësimeve dhe personelit tjetër shkollor, në rregulloren e shkollës;
- Të hartohet një procedurë formale dhe institucionale për raportimin e dhunës në shkollë;
- Të hartohet një procedurë dhe afat kohor për organizimin e zgjedhjeve në të gjitha nivelet, për këshillat e prindërve, nxënësve dhe mësimeve;
- Të identifikohen rolet dhe përgjegjësit e këshillave të shkollës, të bazuar në infrastrukturën ligjore;
- Të identifikohen dhe hartohen plane për aktivitete të lira jashtë plan programit formal shkollor, që do të përmirësojnë sigurinë në shkollë;
- Të hartohen plane funksionale për decentralizimin e shkollës e në veçanti decentralizimi i financave të shkollës;
- Aftësi i mësimeve në menaxhimin e grupeve e në veçanti në menaxhim të tensioneve apo konfliktit;
- Të identifikohet roli dhe përgjegjësia e policisë dhe Ministrisë së Drejtësisë në çështjet e sigurisë dhe dhunës në shkollë;
- Të identifikohet dhe qartësohet roli dhe përgjegjësia e Ministrisë së Arsimit përkrah Drejtorisë Komunale të Arsimit në çështjet e sigurisë në shkollë;
- Në bashkëpunim me DKA-së dhe Drejtorinë e Shërbimeve Publike të Komunës së Prishtinës, të hartohet një plan për qentë endacakë dhe komunikacionin, pasi që janë identifikuar si problem kryesor për nxënësit që udhëtojnë në këmbë në shkollë;
- Të dhënat e këtij hulumtimi të shërbejnë si bazë për të organizuar edhe disa fokus-grupe me nxënës, prindër, mësimeve e drejtues të shkollave, në mënyrë që disa tema e shqetësime të dalin nga ky hulumtim, të studiohen më në thellësi.
- Pas plotësimit të këtij raporti të hulumtimit edhe me të dhënat që dalin nga fokus-grupet, atëherë të hartohet një platformë e nivelit komunal, e cila do të parasheh të gjitha masat dhe investimet e nevojshme për të adresuar problemet e dhunës dhe sigurisë në shkollat e Komunës së Prishtinës.

